



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 80
Prishtinë, më 11 tetor 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR
MË 11 TETOR 2012**

Mbledhjen e kryesoi kryetari **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Xhavit HALITI**.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Alma Lama, Halit Krasniqi, Imri Ahmeti, Teuta Haxhiu, Jeton Svirca, Rexhep Selimi, Fadil Demaku, Anton Quni, Visar Ymeri, Zenun Pajaziti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Afrim Kasolli parashtoi pyetje për ministrin Enver Hoxhaj në lidhje me zgjidhjen e problemit për qytetarët e Kosovës që jetojnë në Kroaci, të cilët për fitimin e nënshtetësisë kroate duhet të dorëzojnë fletëshpërnguljen e lëshuar nga Republika e Serbisë.

Ministri Enver Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Afrim Kasolli.

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me atë se sa i nevojshëm ka qenë numri prej më shumë se 30 anëtarëve të delegacionit të Kosovës, përfshirë edhe Presidenten, gjatë kohës që i zhvilloi punimet Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, mbajtur në muajin shtator të këtij viti.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm.

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me atë se cili është rezultati i prekshëm që ka dalë nga vizita e delegacionit të Kosovës gjatë kohës që i zhvilloi punimet Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, duke pasur parasysh koston e këtij udhëtimi, që është më shumë 100 mijë euro.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm.

Deputetja Hykmete Bajrami parashtroi pyetje për ministrin e Drejtësisë, Hajredin Kuçi, në lidhje me mundësinë që ligjet, të cilat e plotësojnë dhe e ndryshojnë një ligj tjetër, të vijnë në një dokument të vetëm, e jo ta kemi ligjin e ndarë në disa pjesë.

Ministri Hajredin Kuçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Hykmete Bajrami.

Deputetja Kymete Bajraktari parashtroi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me ekzistimin apo jo të statistikave për punëtorët arsimorë, të cilët nuk janë në gjendje të mirë shëndetësore, por për arsye ekonomike janë të detyruar të punojnë.

Ministri Ramë Buja nuk ishte i pranishëm.

Deputeti Visar Ymeri parashtroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me faktin se sa para i ka paguar Kosova Serbisë për përdorimin e kodit telefonik +381, dhe sa para i janë paguar Monakos për përdorimin e kodit telefonik +377.

Ministri Besim Beqaj nuk ishte i pranishëm.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme
4. Votimi i Raportit vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011,
5. Interpelanca e ministrit Enver Hoxhaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së lidhur me gjendjen në politikën e jashtme të Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pagat e funksionarëve publikë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për komunikimet elektronike,
11. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011,
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave,

13. Shqyrtimi i Statutit të Universitetit të Prishtinës,
14. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Alma Lama, lidhur me shpenzimin e fondeve publike nga Qeveria e Kosovës.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme

Kuvendi i miratoi pa asnjë vërejtje procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 13 dhe 17 shtator 2012.

4. Votimi i Raportit vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011

Kryetari në lidhje me këtë pikë tha se diskutimet lidhur me Raportin vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011 janë mbajtur në mbledhjen plenare të datës 17 shtator 2012, mirëpo në mungesë të kuorumit në mbledhjen e lartpërmendur nuk ka qenë e mundur të vazhdohet me procedimin e kësaj pike.

Ai më pas e hodhi në votim Raportin vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 53,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi Raportin vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011.

5. Interpelanca e ministrit Enver Hoxhaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së lidhur me gjendjen në politikën e jashtme të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i LDK-së, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë ministrin Enver Hoxhaj lidhur me gjendjen në politikën e jashtme të Kosovës.

Ai më tej i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar, në bazë të vendeve që kanë në Kuvend, dhe për deputetët pa grup parlamentar, e cila është përcaktuar në bazë të Rregullores së Kuvendit.

Kryetari e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Deputeti Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fillimisht tha se politika e jashtme e Kosovës ka degraduar në shkallën më të ulët të mundshme, duke theksuar se zyrtarët më të lartë qeveritarë e kanë hedhur në plan të parë çështjen e meritave për njohjen e shtetit të Kosovës nga shtetet e ndryshme.

Në vazhdim, ai tha se këtë vit kemi pasur vetëm 6 njohje ndërkombëtare për Republikën e Kosovës.

Më tej, ai u ndal në çështjen e së vërtetës rreth njohjes së Kosovës nga shteti i Malit, duke parashtruar pyetjen se a ka pasur njohje nga ky vend, apo nuk ka pasur fare.

Grupi Parlamentar i LDK-së kërkon nga Qeveria, respektivisht Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës sqarime shtesë nëse Nigeria dhe Uganda e kanë njohur apo jo Republikën e Kosovës, njohje këto të cilat nga personalitetet e ndryshme evropiane dhe amerikane janë mohuar.

Më pas, ai tha se nuk ka pasur përpjekje serioze nga Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe konstatoi se që nga viti 2010 nuk është hapur asnjë ambasadë apo konsullatë e Republikës së Kosovës në shtete të ndryshme.

Deputeti Beqiri i kritikoi edhe emërimet që janë bërë në këto ambasada dhe konsullata, e kritikoi edhe përfaqësimin rajonal të Republikës së Kosovës me fusnotë, për të cilën tha se nuk ka pasur sukses.

Në fjalën e tij të mëtejshme, ai përmendi rastet e shkeljeve për emërimet në administratën e Ministrisë së Punëve të Jashtme, për të cilat tha se ka marrë vendim Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës, por që këto vendime nuk janë zbatuar nga kjo ministri.

Ai më tutje foli për procedurat e emërimit të disa zëvendëskonsujve dhe konsujve në disa ambasada të Kosovës nëpër shtete të caktuara.

Në fund, deputeti Beqiri i paraqiti para Kuvendit rekomandimet e Grupit Parlamentar të LDK-së lidhur me gjendjen në politikën e jashtme të Kosovës dhe i ftoi deputetët për miratimin e tyre.

Diskutimi i plotë i deputetit Ismet Beqiri është dhënë në transkript.

Ministri Enver Hoxhaj tha se politika e jashtme e një vendi është interes nacional dhe reflektim i unitetit politik, ndërsa pikënisja e historisë së re të Kosovës në politikën e jashtme ka filluar pikërisht në këtë Kuvend para afro 5 vjetëve me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.

Procesi i njohjeve është i pakthyeshëm dhe i pandalshëm dhe Kosova e pavarur është pjesë e peizazhit të vendeve të pavarura të Ballkanit Perëndimor, ndërsa qëllim parësor i politikës së jashtme të vendit është kompletimi i njohjeve ndërkombëtare për shtetin e Kosovës nga vendet e ndryshme të botës, theksoi ai.

Në vazhdim ai u fokusua në dokumentin lidhur me lobimin për njohje që janë paraqitur në strategjinë e Qeverisë lidhur me këtë çështje, për të theksuar se fokusi i këtij lobimi ka qenë i drejtuar në tri grupe të shteteve: shteteve që janë afër njohjes, shteteve që kanë qëndrim pozitiv lidhur me pavarësinë e Kosovës dhe shteteve që kanë qëndrim neutral lidhur me pavarësinë e Kosovës.

Më tej, ai theksoi se brenda 17 muajve Kosova është njohur nga 17 shtete, ndërsa ai si ministër ka vizituar mbi 42 shtete, të cilat nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës.

Më pas, ministri Hoxhaj vlerësoi se çështja e 5 vendeve të BE-së të cilat nuk e kanë njohur Kosovën ka të bëjë me vetë zhvillimet e brendshme në ato shtete dhe se këto 5 vende nuk paraqesin një grup shtetesh që kanë qëndrim kundër pavarësisë së Kosovës. Disa nga këto 5 shtete e kanë pranuar pasaportën e Republikës së Kosovës dhe kanë votuar për anëtarësimin e Kosovës në organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Më pastaj, ministri u fokusua në faktorët determinues që e kanë penguar procesin e njohjeve deri më tani. Në lidhje me njohjen e Kosovës nga shteti i Malit, ai tha se ka ndodhur një

keqkuptim për çka shprehu keqardhjen e tij, ndërsa lidhur me njohjet e reja theksoi se është dinamizuar në masë të madhe trendi i njohjeve.

Ministri Hoxhaj konstatoi se për një vit e gjysmë janë zhvilluar 150 takime bilaterale, janë nënshkruar 105 marrëveshje bilaterale, 10 marrëveshje multilaterale, 9 marrëveshje ndërkombëtare dhe janë iniciuar 72 marrëveshje në fusha të ndryshme.

Në lidhje me emërimet në ambasadat dhe konsullatat e Republikës së Kosovës, ai theksoi se është përzgjedhur stafi sa më profesional që është e mundur, ndërsa në mandatin e tij si ministër i Punëve të Jashtme, askush nga stafi civil nuk është shkarkuar nga ai.

Ministri Enver Hoxhaj foli edhe për rëndësinë e Raportit të Komisionit Evropian për Studimin e Fizibilitetit për Kosovën.

Diskutimi i plotë i ministrit Enver Hoxhaj është dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi diskutimin lidhur me interpelancën me ministrin Enver Hoxhaj.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Skender Hyseni - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albin Kurti - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Blerim Shala - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Suzan Novobërdaliu - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa Petar Miletij - në emër të Grupit Parlamentar SLS, dhe Ramiz Lladrovci, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Myzejene Selmani, Hykmete Bajrami, Idriz Vehapi, Nazane Breca, Blerta Deliu - Kodra, Arben Gashi, Sevdije Lama, Berat Buzhala, Ismet Beqiri, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Arsim Bajrami, Fadil Demaku, Hydajet Hyseni, ministri Enver Hoxhaj dhe kryeministri Hashim Thaçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputeti Arben Gashi kërkoi falje nga ministrja Vlora Çitaku, nëse ajo apo ndonjë deputete tjetër mund të preket nga diskutimi i tij, për të cilin tha se nuk ka pasur asnjë qëllim që ta ofendojë asnjë deputet apo ministër.

Deputetja Teuta Sahatqija tha se diskutimin e saj do ta dorëzojë në formë të shkruar.

Në fund, deputeti Ismet Beqiri, si propozues i çështjes, theksoi se, në ndërkohë, të gjitha grupet parlamentare e kanë harmonizuar tekstin që përbëhet prej gjashtë rekomandimeve, të cilat ai i paraqiti para Kuvendit.

Kryetari në vazhdim konstatoi se në sallë janë të pranishëm 70 deputetë.

Ai më pas e hodhi në votim tekstin e harmonizuar të Propozim-rekomandimeve lidhur me gjendjen në politikën e jashtme të Kosovës, të përkrahur nga të gjitha grupet parlamentare.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 67,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, pas interpelancës me ministrin Enver Hoxhaj lidhur me gjendjen në politikën e jashtme të Kosovës, me propozim të grupeve parlamentare: LDK, PDK, VV, AAK, KKR, SLS, nxori këto:

REKOMANDIME

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon përgjegjësi dhe përgjegjshmëri nga Qeveria, veçmas për çështjen e njohjes, përkatësisht mosnjohjes nga tri shtete dhe për këtë ta informojë Kuvendin e Republikës së Kosovës deri në fund të këtij viti.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria që urgjentisht t'i sqarojë kompetencat e anëtarëve të Qeverisë, duke i përshkruar saktë obligimet dhe detyrat e punës të të gjithë përfaqësuesve të kabinetit qeveritar që merren me politikë të jashtme,
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria që të merren hapa të menjëhershëm për anëtarësim në organizatat e ndryshme ndërkombëtare, në Këshillin e Evropës dhe të raportojnë në Kuvend në baza të rregullta (tremujore) lidhur me avancimin e procesit të anëtarësimit.
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria krijimin e partneritetit strategjik bilateral.
5. Kuvendi i Republikës së Kosovës e obligon Ministrinë e Punëve të Jashtme që t'i përgjigjet Komisionit për Politikë të Jashtme në baza të rregullta.
6. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria që të ndalojë politizimin e shërbimit diplomatik të Kosovës dhe të veprojë në përputhje me ligjet në fuqi dhe me Kushtetutën me rastin e emërimeve apo ngritjes në detyrë.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pagat e funksionarëve publikë

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për pagat e funksionarëve publikë.

Ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, në emër të Qeverisë së Kosovës kërkoi që Projektligji për pagat e funksionarëve publikë të tërhiqet nga procedurat parlamentare.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi edhe deputeti Idriz Vehapi - në emër të Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, i cili e përkrahu propozimin e lartpërmendur.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim propozimin që Projektligji për pagat e funksionarëve publikë të tërhiqet nga procedurat parlamentare.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash të deklaruara të deputetëve vendosi që Projektligji për pagat e funksionarëve publikë të tërhiqet nga procedurat parlamentare.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Projektligji për pagat e funksionarëve publikë i kthehet Qeverisë së Republikës së Kosovës për rihartim.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale.

Ministri Hajredin Kuçi tha se ky projektligj i përcaktuar në programin legjislativ për vitin 2012 paraqet njërin nga prioritetet e ministrisë që ai drejton dhe ka për qëllim krijimin dhe avancimin e bazës ligjore për konfiskimin e pasurisë së përfituar nëpërmjet veprës penale, me qëllim të parandalimit dhe luftimit sa më të suksesshëm të kriminalitetit të organizuar.

Në vazhdim, ai theksoi se ky projektligj I përcakton llojet e veprave penale, të cilat mund të rezultojnë me përfitimin e dobisë pasurore, kur procedurat e përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale nuk janë të mjaftueshme.

Ky projektligj përcakton gjithashtu edhe konfiskimin e pasurisë së fituar nëpërmjet veprës penale për rastet kur ajo gjendet në pronësi të personit i cili ka vdekur, si dhe rastet kur ai gjendet në arrati, konfiskimi i përkohshëm gjatë pezullimit të hetimit, si dhe destinimi i pasurisë së konfiskuar, theksoi ministri Kuçi.

Më pas, ministri u fokusua në strukturën e projektligjit dhe përmendi ligjet tjera të kësaj fushe që rregullojnë çështjet e përafërta, si: Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Ligji mbi përgjegjësinë penale të personave juridikë, Ligji për administrimin e pasurisë së konfiskuar dhe të sekuestruar etj.

Në fund, ministri Kuçi i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arben Gashi - në emër të Komisionit funksional për Legjislacion, Behar Selimi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Haki Demolli - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albulena Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ahmet Isufi - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Alma Lama, Bekim Haxhiu, Vjollca Krasniqi, Afrim Kasolli dhe ministri Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 41,
Kundër ----- 30,
Abstenime ----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfutur me vepër penale.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si Komision Funksional dhe Raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për provimin e jurisprudencës.

Ministri Hajredin Kuçi tha se ky projektligj përcakton krijimin dhe avancimin e bazës ligjore për ngritjen e cilësisë së mësimit vazhdues në fushën e jurisprudencës të kuadrove të reja.

Në vazhdim, ai theksoi se projektligji përfshin të gjitha ndryshimet e parapara, të cilat janë identifikuar se janë të nevojshme të ndryshohen dhe plotësohen, duke vënë theksin në institucionin, i cili do ta emërojë komisionin për provimin e jurisprudencës, e sipas këtij projektligji, ky komision do të emërohet nga ministri i Drejtësisë.

Më pas, ministri u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për provimin e jurisprudencës.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për provimin e jurisprudencës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arsim Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Albulena Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", Time Kadrijaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Amir Ahmeti - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe ministri Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 59 deputetë, andaj nuk ka kuorum për të proceduar me votimin e kësaj pike.

Kryesuesi tha se vazhdimi e saj do të bëhet më 12 tetor 2012, në orën 10:00.

Kryesuesi i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme, në orën 18:20 minuta.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, më 12 tetor 2012

Mbledhjen e kryesoi nënkryetari Xhavit HALITI, ndërsa i ndihmoi Petar Miletqi, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi Xhavit Haliti e deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare, të filluar më 11 tetor 2012.

Ai procedoi me pikat e mbetura të rendit të ditës të mbledhjes së djeshme.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës

Kryesuesi tha se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në mbledhjen e djeshme, ndërsa në radhë është procedimi me votim i Projektligjit për provimin e jurisprudencës.

Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për provimin e jurisprudencës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 45,
Kundër ----- 38,
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për provimin e jurisprudencës.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si Komision Funkcional dhe Raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Ministri Nenad Rashiq tha se ky projektligj themelon një kornizë legjislative të vetme dhe të unifikuar për konsolidimin, plotësimin dhe rishikimin e ligjeve dhe akteve tjera juridike, mbi bazën e të cilave vepron skema aktuale pensionale e financuar nga shteti.

Në vazhdim, ai theksoi se në këtë projektligj përfshihen skemat e pensionit bazik, beneficioni i pensionit bazik të moshës, pensioni i aftësisë së kufizuar, pensioni i parakohshëm për punëtorët e kompleksit “Trepça”, beneficioni i pensionit të parakohshëm, pensionet invalidore të punës dhe pensionet familjare.

Më tej, ministri theksoi se nevoja për këtë projektligj është shumë e madhe, ngase nëpërmjet tij do të rregullohen kërkesat e kamotshme të grupeve të interesit, përkatësisht qytetarëve të vendit tonë, të cilët kanë kontribuar në ish-sistemin e sigurimeve pensionale dhe invalidore, të cilët padrejtësisht nuk kanë mundur t'i realizojnë të drejtat e tyre për pension.

Më pas, ministri u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit, ndërsa, në fund, i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Salihe Mustafa - në emër të Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Bahri Thaçi - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Liburn Aliu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Donika Kadaj-Bujupi - emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gëzim Kelmendi - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Goran Marinković - në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Fikrim Damka - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Xhevahire Izmaqi, Nazane Breca, Aurora Bakalli, Haki Demolli, Muhamet Mustafa, Hydajet Hyseni, Teuta Sahatqija, Visar Ymeri, Nijazi Idrizi, Sali Asllanaj, Bekim Haxhiu, Salihe Mustafa, Sadri Ferati, Fikrim Damka, Rita Hajzeraj-Beqaj, Zenun Pajaziti dhe ministri Nenad Rashiq, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 45,
Kundër ----- 38,
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Kuvendi engarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si Komision Funkcional dhe Raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për komunikimet elektronike

Kryesuesi Xhavit Haliti i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funkcional Raportues për Projektligjin për komunikimet elektronike.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e paraqiti kryetari i këtij komisioni, deputeti Zenun Pajaziti.

Kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi I miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73 dhe amendamentin nr. 74.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 45,
Kundër ----- 15,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për komunikimet elektronike.

11. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011

Deputeti Ali Sadriu, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrje të Financave Publike, tha se si komision e kanë shqyrtuar Raportin e Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011 dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare.

Ai në fund e përkrahu Raportin e Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Ramiz Lladrovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ali Sadriu - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afrim Hoti - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Bali Muharremaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Sevdije Lama - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Sali Morina, Lirije Kajtazi dhe Hashim Dëshishku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e Raportin e Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011, bashkë me rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 52,
Kundër ----- 4,
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin e Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011, bashkë me rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave

Deputeti Xhevdet Neziraj, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, tha se si komision e kanë shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për

emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave dhe kanë rekomanduar miratimin në mbledhje plenare.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave.

Nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim lidhur me këtë pikë.

Kryesuesi e hodhi në votim Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 35,
Kundër ----- 10,
Abstenime ----- 13.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

I. Kuvendi emëroi anëtarët në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave, si në vijim:

1. Faik Çollaku, anëtar
2. Nexhat Hasani, anëtar
3. Përparim Hoxha, anëtar
4. Samir Lleshi, anëtar
5. Bujar Krasniqi, anëtar
6. Dejan Mitiq, anëtar

II. Mandati i të emëruarve nga pika nr. I. e këtij vendimi zgjat deri më 31 dhjetor 2013.

13. Shqyrtimi i Statutit të Universitetit të Prishtinës

Deputeti Ramë Vataj, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, tha se si komision e kanë shqyrtuar Propozim-statutin e Universitetit të Prishtinës dhe kanë rekomanduar miratimin e tij në mbledhje plenare, sipas ndryshimeve të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e Propozim-statutit të Universitetit të Prishtinës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Sadri Ferati - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afrim Kasolli - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", Teuta Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Jeton Svirca - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Muhamet Mustafa, Visar Ymeri, Albulena Haxhiu, Alma Lama, Ramë Vataj dhe Afrim Kasolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Propozim-statutin e Universitetit të Prishtinës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 44,
Kundër ----- 11,
Abstenime ----- 6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Statuti i Universitetit të Prishtinës, sipas ndryshimeve të propozuara nga Komisioni Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.

14. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Alma Lama ,lidhur me shpenzimin e fondeve publike nga Qeveria e Kosovës

Kryesuesi Xhavit Haliti, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, e ftoi deputeten Alma Lama për paraqitjen dhe arsyetimin e kërkesës për debat parlamentar.

Alma Lama, në cilësinë e propozuesit të këtij debati, kërkoi që ky debat të shtyhet për datën 15 tetor 2012, me arsyetimin se momentalisht në sallë nuk është i pranishëm asnjë ministër i Kabinetit qeveritar.

Kryesuesi kërkoi nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare deklarin lidhur me propozimin e deputetes Alma Lama.

Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se grupi që ai përfaqëson është i gatshëm për mbajtjen e debatit dhe nuk ka nevojë që kjo pikë të shtyhet.

Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se në parim janë të interesuar për debat, por rëndësia e debatit qëndron në atë se dëshirojnë të bashkëkomunikojnë me Ekzekutivin, prandaj nisur nga kjo, grupi që ai përfaqëson e përkrah kërkesën për shtyrjen e këtij debati.

Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, tha se grupi që ai përfaqëson konsideron se nuk ka rrethana për mbajtjen e këtij debati në mbledhjen e sotme, për shkak se kërkohet që në sallë të jenë të pranishëm së paku disa nga ministrat e Kabinetit qeveritar.

Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, vlerësoi se për mbajtjen e një debati do të duhej që Qeveria të jetë e pranishme në sallë.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, tha se duke pasur parasysh materialin e ofruar për debat, mund të debatohet, por objektin e debatit e sheh si çështje e cila tashmë ka kaluar.

Sasha Milosavleviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se grupi që ai përfaqëson konsideron se mund të vazhdohet me mbajtjen e debatit në mbledhjen e sotme.

Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, tha se grupi që ai përfaqëson konsideron se mund të vazhdohet me mbajtjen e debatit në mbledhjen e sotme.

Për këtë pikë të rendit të ditës, më tej, diskutuan edhe deputetët: Alma Lama dhe Adem Grabovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi, Xhavit Haliti, para se ta hedhë në votim propozimin e deputetes Alma Lama, për shtyrje të këtij debati, konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për ta votuar këtë propozim.

Ai, në fund, tha se për këtë pikë të rendit të ditës vendosë Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e saj të radhës.

Kryesuesi i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme, në orën 16:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale